

Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Shtator 2022

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR CESK MERR PJESE NË EVENTIN :
"ADVANCING THE CYBER RESILIENCE AGENDA WITH THE
WESTERN BALKANS PARTNERS"**



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, znj. Vilma Tomço, pjesëmarrës në "Advancing the Cyber Resilience Agenda with The Western Balkans Partners", në Bruksel.

Ky event, ku morën pjesë zyrtarë dhe përfaqësues të Rajonit të Ballkanit Perëndimor, si dhe institucionet e BE-së, shtetet anëtare dhe palët kryesore të interesit, synonte rritjen e bashkëpunimit duke avancuar në një agjendë konkrete dhe të orientuar drejt angazhimeve të BE-së dhe partnerëve në Ballkanin Perëndimor.

Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit parashtruan disa mekanizma për të adresuar sfidat aktuale, duke përfshirë krijimin e POC-ve, përfshirjen më të ngushtë të partnerëve dhe agjencive të Ballkanit Perëndimor në ushtrimet praktike të udhëhequra nga BE, ndarjen e vlerësimit të kërcënimeve dhe ndjekjen e bashkëpunimit më të ngushtë. mbi proceset ligjore dhe rregullatore për sigurinë kibernetike si NIS2.

SAMSUNG konfirmon se të dhënat e klientëve janë kompromentuar gjatë muajit Korrik



Gjigandi i pajisjeve elektronike Samsung ka konfirmuar se gjatë muajit Korrik, të dhënat e klientëve dhe informacionet e tyre personale janë kompromentuar.

Kjo është hera e dytë që Samsung konfirmon një shkelje të të dhënave për vitin 2022. Në mars, kompania pranoi se grupi i hackerave Lapsus\$ - i njëjti grup që depërtoi në Nvidia, Microsoft dhe T-Mobile - ka fituar akses në pothuajse 200 GB të dhëna konfidenciale.

<https://techcrunch.com/2022/09/02/samsung-data-breach/>

KONTAKT

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë Albania 04-22-21039

Email: info@cesk.gov.al

Web: www.cesk.gov.al



Propozimi i ri i Bashkimit European për Sigurinë Kibernetike synon krimin kibernetik



Ligjvënësit kërkojnë forcimin e e kërkesave të sigurisë kibernetike në Bashkimin European, duke ndryshuar legjislacionin e ri për të forcuar kërkesat e sigurisë për të gjithë produktet digjitale.

Ligjislacioni i propozuar, i titulluar Akti i Rezistencës Kibernetike, do të mbulojë gjithçka nga kompjuterët dhe telefonat celularë, te pajisjet inteligjente të kuzhinës dhe lodrat digjitale për fëmijë. Legjislacioni i ri, i cili u publikua nga Komisioni European në fillim të muajit Shtator, përcakton që produktet të dizajnohen, zhvillohen dhe prodhohen në mënyrë të tillë që ulen rreziqet e sigurisë kibernetike.

<https://www.weforum.org/agenda/2022/09/new-european-union-cybersecurity-proposal-takes-aim-at-cybercrimes/>

Uber bie pre e sulmeve kibernetike



Uber pohon se aktori i kërcënimit pas sulmit kibernetik nuk ka akses në mjedisin e prodhimit të kompanisë, asnjë llogari përdoruesi ose bazë të dhënash që përdor për të ruajtur informacione të ndjeshme.

Megjithatë, hackerat kanë fituar akses në të dhënat e një pajisjeje që ekipi financiar i Uber përdor për të menaxhuar faturat. Kompania ka deklaruar se janë marrë masa të shumta mbrojtëse në përgjigje të sulmit.

<https://www.cybersecuritydive.com/news/uber-attack-details/632193/>